



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 117

6 shtator

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7759 datë 17.8.2012	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare	6685
Vendim i KM nr. 482, datë 1.8.2012	Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015	6686
Vendim i KM nr. 490, datë 1.8.2012	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe INSTAT-in	6688
Vendim i KM nr. 492, datë 1.8.2012	Për miratimin, në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet të dyja vendeve	6688
Vendim i KM nr. 493, datë 1.8.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së terminalit lindor në portin e Durrësit dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë “EMS Shipping and Trading GMBH”, Gjermani.....	6697
Vendim i KM nr. 494, datë 1.8.2012	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier”	6697
Vendim i KM nr. 495, datë 1.8.2012	Për dhënie të çmimeve dhe shpërblimeve shkencore personave që kanë punuar për krijimin dhe përmirësimin e sistemeve elektronike në fushën e drejtësisë	6698
Vendim i KM nr. 496, datë 1.8.2012	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ushtrimit të së drejtës së aksesit për personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme	6699

Vendim i KM nr. 497, datë 1.8.2012	Për miratimin e dëmshtëpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist	6704
Vendim i KM nr. 498, datë 1.8.2012	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te komuna Farkë, Tiranë, të pronës nr. 193, me emërtim “Group depo M (Ish-reparti ushtarak nr. 5011/53)”, në Lundër, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar	6714
Vendim i KM nr. 499, datë 1.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, të ndryshuar	6717
Vendim i KM nr. 500, datë 1.8.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të personelit të hetimit, të inspektimit dhe të shërbimeve mbështetëse në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar	6718
Vendim i KM nr. 501, datë 1.8.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 413, datë 26.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës, si dhe të strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të Autoritetit të Aviacionit Civil”, të ndryshuar ..	6721
Vendim i KM nr. 502, datë 1.8.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	6723
Vendim i KM nr. 503, datë 1.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, të ndryshuar	6725
Vendim i KM nr. 504, datë 1.8.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar	6727
Vendim i KM nr. 505, datë 1.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 1061, datë 8.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve.....	6729
Vendim i KM nr. 506, datë 1.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”	6731

Vendim i KM nr. 507, datë 1.8.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar	6732
Vendim i KM nr. 508, datë 1.8.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar	6734
Vendim i KM nr. 509, datë 1.8.2012	Për lirim, mandatin dhe rimandatin e disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	6735

DEKRET
Nr. 7759, datë 17.8.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 1. Miri Astrit Xhelili | 16. Genci Ramadan Toska |
| 2. Ridvan Halit Dule | 17. Astrit Leonat Shkurti |
| 3. Fitret Niazi Dule (Talelli) | 18. Taulant Leonat Shkurti |
| 4. Pllumb Fran Marku | 19. Amalia Xhorxhi Kapsalidhi (Jani) |
| 5. Elvis Pllumb Marku | 20. Meri Leonard Jäschke (Lufi) |
| 6. Eva Pllumb Marku | 21. Iton Alfons Theka |
| 7. Apostol Fidai Qazimllari | 22. Ira Bardhyl Balaj |
| 8. Mirsa Iljas Qazimllari (Xhaollari) | 23. Alexander Ergys Metalija |
| 9. Kristina Apostol Qazimllari | 24. Filomena Mark Maka |
| 10. Armando Apostol Qazimllari | 25. Albana Gëzim Filla (Karni) |
| 11. Kleanth Hajro Caca | 26. Kostaqi (Kostakis) Dhimiter Leni (Lenis) |
| 12. Zhuljeta Zeqir Renner | 27. Bledar Ali Alijaj |
| 13. Robert Stefan Vreto | 28. Kastriot Ajet Skura |
| 14. Mimoza Lilo Wetzl (Mujollari) | 29. Blerina Isak Vorwerk (Faqolli) |
| 15. Anxhela Gjon Mujollari | 30. Daniela Dritan Zeneli |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



VENDIM
Nr. 482, datë 1.8.2012

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2013-2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015, sipas lidhjes nr. 1 “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 167, datë 29.2.2012 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavaneve të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2013-2015”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja Nr. 1 - Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, ne milion Lekë

	viti 2013				viti 2014				viti 2015			
	600-501	602-606	230-232	Totali	600-501	602-606	230-232	Totali	600-501	602-606	230-232	Totali
Emertimi i Institucioneve Buxhetore	Paga-Sq.shiq	Te tjera Korente	Investimet brendshme	Transferime per Fondet Speciale SSH-HSKH-KP	Paga-Sq.shiq	Te tjera Korente	Investimet brendshme	Transferime per Fondet Speciale SSH-HSKH-KP	Paga-Sq.shiq	Te tjera Korente	Investimet brendshme	Transferime per Fondet Speciale SSH-HSKH-KP
1 Presidencia	92	50	5	147	95	52	5	152	99	53	5	157
2 Kuvendi	507	285	5	797	525	295	5	825	544	300	5	849
3 Keshilli Ministrave	177	205	5	387	183	211	5	399	190	215	5	410
4 Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjikut	803	250	200	2,253	812	259	200	2,291	863	269	200	2,332
5 Ministria e Bujqesise, Ushqim, dhe Mbrojtjes se Konsumit	1,726	2,050	300	5,076	1,790	2,142	300	5,232	1,877	2,206	440	5,523
6 Ministria e Punëve Publike, Transport dhe Telekomunik.	870	2,720	1,902	5,492	950	2,802	5,596	6,231	1,003	2,880	9,229	27,509
10 Ministria e Financave	3,379	1,000	70	4,449	3,449	1,030	80	4,559	3,616	1,060	100	4,776
11 Ministria e Arsimit dhe Shkencave	28,608	6,350	500	35,458	29,668	6,691	500	36,859	30,707	6,891	700	41,298
12 Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	954	520	20	1,494	988	546	10	1,544	1,025	557	10	1,592
13 Ministria e Shendetesise	2,443	1,420	300	4,163	2,531	1,563	300	4,394	2,675	1,600	320	4,595
14 Ministria e Drejtësisë	3,870	780	80	4,730	4,009	833	80	4,922	4,157	850	80	5,087
15 Ministria e Punëve te Jashtme	883	1,090	10	1,983	915	1,123	10	2,048	949	1,146	10	2,105
16 Ministria e Brendshme	11,863	2,950	100	15,313	12,238	3,059	100	15,797	12,741	3,145	100	16,386
17 Ministria e Mbrojtjes	7,223	4,770	150	12,143	7,483	4,913	100	12,496	7,760	5,045	200	17,656
18 Shërbimi Informativ Sigurues	984	255	10	1,249	1,019	267	10	1,296	1,057	273	10	1,340
19 Drejtoria e Radio Televizionit	0	310	0	310	0	319	0	319	0	329	0	329
20 Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	125	33	5	163	135	34	5	174	140	35	5	180
21 Akademia e Shkencave	33	43	1	77	35	44	1	80	36	46	1	83
24 Kontrolli i Lartë i Shetit	211	42	4	257	224	43	4	271	232	45	4	281
25 Ministria e Punës, Casht, Sociale dhe Shansave te Bara.	1,125	20,500	15	21,640	1,171	21,270	15	22,456	1,214	22,279	15	23,508
26 Ministria e Mbrojtjes, Pjese dhe Administrimit te Urares	920	200	100	1,220	964	206	100	1,270	999	210	100	1,309
28 Prokuroria e Pergjithshme	983	250	10	1,243	1,018	258	10	1,286	1,056	265	10	1,331
29 Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,377	252	10	1,639	1,427	260	10	1,697	1,479	267	10	1,757
30 Gjykata Kushtetuese	76	13	1	90	79	14	1	94	84	14	1	99
31 Agjencia Telegrafike Shqiptare	0	170	0	170	0	170	0	170	0	174	0	174
40 Partia Politike	351	125	3	479	368	129	3	500	386	133	3	522
50 Institut Statistikes	28	25	1	54	29	26	1	56	31	27	1	59
55 Shkolle e Magistratures	0	0	1,000	1,000	0	0	1,000	1,000	0	0	1,000	1,000
56 Fondi i Zhvillimit Shqiptar	9	83	2	94	10	85	2	97	11	88	2	101
57 Qendra Kombetare e Kinematografise	59	21	2	82	61	22	2	85	65	22	2	89
63 Keshilli i Lartë i Drejtësisë	68	12	2	82	70	13	2	85	73	13	2	88
66 Avokatit i Popullit	33	9	2	44	35	9	2	46	35	9	2	46
67 Komisioni i Shërbimit Civil	74	618	3	695	76	618	3	717	79	621	3	703
73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	62	23	3	88	64	23	3	90	67	24	3	94
76 Inspektorati i Lartë Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	48	8	2	58	50	9	2	61	52	9	2	63
77 Autoriteti i Konkurences	82	44	5	131	85	45	5	135	88	47	5	140
78 Ministria e Integritetit	8	5	1	14	9	5	1	15	10	5	1	16
82 Keshilli Kombetar Kontabilitetit	19	5	1	25	20	5	1	26	22	5	1	28
86 Avokatit i Prokurimeve	190	244	65	499	197	251	60	508	204	254	60	518
87 Institucione te tjera Qeveritare	14	72	1	87	15	74	1	90	16	76	1	93
88 Mbeshtetje per shqetisime civile	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
89 Komisionet per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	34	9	1	43	36	9	1	46	37	9	1	47
91 Komisionet per Mbrojtjen nga Diskriminimi	27	7	1	35	28	7	1	36	29	7	1	37
92 Instituti i Studimit te Komunitetit	17	11	1	29	18	11	1	30	20	11	1	32



VENDIM
Nr. 490, datë 1.8.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE
INSTAT-IN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin buxhetor 04220 “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, t’i zbritet nga shpenzimet e personelit fondi prej 7 766 000 (shtatë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

2. INSTAT-it, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin buxhetor “Veprimtaria statistikore”, t’i shtohet në shpenzimet e personelit fondi prej 7 766 000 (shtatë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, INSTAT-i dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 492, datë 1.8.2012

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI,
PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT HEKURUDHOR KUFITAR NDËRMJET
TË DYJA VENDEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet të dyja vendeve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI, MBI KRYERJEN E TRANSPORTIT
HEKURUDHOR KUFITAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Malit të Zi (të referuara më poshtë si palët kontraktuese),

duke dëshiruar të adaptojnë procedurën e organizimit të transportit kufitar hekurudhor, të vendosur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Malit të Zi, me anë të marrëveshjes për organizimin e trafikut kufitar hekurudhor, ndërmjet të dyja vendeve, të nënshkruar më 16 maj 2006, me kërkesat e reja të tregut, me qëllim rritjen e aftësisë konkurruese të shërbimeve hekurudhore,

palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë marrëveshjen e re ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Malit të Zi, mbi kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet dy vendeve (këtej e tutje e quajtur si marrëveshja), me dispozitat e mëposhtme.

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllime të zbatimit të marrëveshjes do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. “Kryerja e transportit kufitar” do të thotë zbatimi i të gjitha rregullave dhe rregulloreve të palëve kontraktuese dhe autoriteteve hekurudhore që zbatohen për kalimin e kufirit të personave dhe të bagazheve, si dhe për importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave.

2. “Deklarata e rrjetit kufitar” do të thotë deklarata që përcakton në detaje rregullat e përgjithshme, afatet, procedurat dhe kriteret në lidhje me tarifat dhe skemat e shpërndarjes së kapaciteteve të infrastrukturës në zonë. Ajo duhet, gjithashtu, të përmbajë informacione të tjera të kërkuara për të bërë të mundur aplikimin për kapacitetin e infrastrukturës dhe mund të jetë pjesë përbërëse e deklaratës së rrjetit kufitar të administruesit të infrastrukturës të palëve kontraktuese.

3. “Vija kufitare hekurudhore” është vija hekurudhore midis stacioneve kufitare të të dyja vendeve.

4. “Seksioni kufitar” është pjesa e vijës hekurudhore midis stacionit kufitar dhe kufirit shtetëror të palëve kontraktuese.

5. “Stacion kufitar” është një stacion hekurudhor në zonë, i përcaktuar në marrëveshje.

6. “Shtet vendas” është shteti, territori i të cilit është pjesë e zonës, ku do të kryhet transporti kufitar nga ana e personelit zyrtar të shtetit tjetër.

7. “Hekurudha vendase” do të thotë hekurudha e shtetit vendas.

8. “Mallrat” janë të gjitha sendet, paratë, pakot, bagazhet dhe mjetet e transportit të transferuara nëpërmjet kufirit shtetëror.

9. “Administruesi i infrastrukturës” është çdo kompani, ent ligjor ose ndërmarrje që i është dhënë e drejta për administrimin e infrastrukturës hekurudhore. Kjo mund të përfshijë edhe administrimin dhe rregullimin e sistemeve të transportit, të kontrollit dhe të sigurisë.

10. “Shërbimi hekurudhor ndërkombëtar” është çdo shërbim i transportit të mallrave dhe udhëtarëve, ku treni kalon kufirin e palës kontraktuese; treni mund të bashkohet dhe/ose të ndahet dhe seksionet e ndryshme mund të kenë origjina dhe destinacione të ndryshme, me kusht që të gjithë vagonët e mallrave dhe të udhëtarëve të kalojnë kufirin.



11. “Rrjet” nënkupton të gjithë infrastrukturën hekurudhore në pronësi dhe/ose të drejtuar nga një administrues i infrastrukturës.

12. “Shtet fqinj” është territori i shtetit të palës tjetër kontraktuese.

13. “Personeli zyrtar” nënkupton personat e autoriteteve kufitare shtetërore kompetente të palëve kontraktuese, që kryejnë kontrollin e detyrueshëm kufitar në territorin e shteteve vendase dhe fqinje, si edhe lëvizjen e trenave.

14. “One-Stop-Shop (OSS)” do të thotë vendi i administruesit të infrastrukturës të palëve kontraktuese, i cili së bashku me përfaqësuesit e administruesve të tjerë të infrastrukturës formojnë rrjetin ndërkombëtar, ku përdoruesve u krijohen lehtësira për të hyrë në infrastrukturën hekurudhore ndërkombëtare në zonë.

15. “Dritare e vetme” nënkupton vendin ku të gjitha shërbimet doganore të kryhen në një dhe të vetmin vend në zonë nga autoritetet doganore të palëve kontraktuese.

16. “Personeli hekurudhor” është i gjithë personeli që në emër të një transportuesi hekurudhor ose të një administruesi të infrastrukturës hekurudhore merr pjesë në kryerjen e transportit hekurudhor kufitar.

17. “Transportues hekurudhor” është çdo ndërmarrje publike ose private e licencuar në bazë të legjislacionit të zbatueshëm të palëve kontraktuese, veprimtaria kryesore e të cilit është të ofrojë shërbime për transportin hekurudhor të mallrave dhe/ose udhëtarëve dhe që siguron vetë tërheqjen.

18. “Stacioni i përbashkët kufitar” është stacioni kufitar në zonë ku bashkërisht kryhet transporti kufitar.

19. “Zonë” është pjesa e territorit të shtetit vendas, në të cilën personeli zyrtar i shtetit fqinj është i autorizuar për të kryer transportin kufitar.

Neni 2

Dispozita të përgjithshme, objektivat dhe parimet

Objekti i kësaj marrëveshjeje është thjeshtimi i kryerjes së transportit kufitar dhe zvogëlimi i kohës së pritjes në pikat e kalimit kufitar me anë të:

- kryerjes së veprimtarive të transportit kufitar të një shteti për në territorin e shtetit tjetër nga personeli zyrtar dhe hekurudhor;

- vendosjes së rregullave për kryerjen e transportit kufitar të një shteti në trenat që lëvizin në territorin e shtetit tjetër nga ana e personelit zyrtar ose hekurudhor;

- përcaktimit se:

- në cilin prej stacioneve të shtetit vendas, shteti fqinj mund të ngrejë pikat e transportit kufitar për kontrollin kufitar;

- në cilat zona autoritetet kufitare të shtetit fqinj mund të kryejnë transportin kufitar në stacionet edhe në trena në të dyja drejtimet në territorin e shtetit vendas;

- zonat.

Palët kontraktuese garantojnë:

- hyrje të lirë për transportuesit hekurudhorë, të cilët dëshirojnë të hyjnë në zonë me qëllim kalimin e kufirit me anë të një procedure të thjeshtuar të pranimit reciprok të licencave, të certifikatave të sigurisë, të tërheqjes, të mjeteve lëvizëse dhe të lejeve të drejtimit për drejtuesit e lokomotivave;

- mosdiskriminimin dhe konkurrencën e ndershme në lidhje me hyrjen e lirë;

- pranimin e standardeve ndërkombëtare, si dhe të dokumenteve të mallrave dhe të udhëtarëve;

- pranimin e dokumenteve të tjera të transportit të njohura ndërkombëtarisht;

- liria e ndërmarrjeve hekurudhore për të organizuar procedurat e veta të transportit kufitar hekurudhor, duke bërë marrëveshje me autoritetet kufitare respektive, sipas përcaktimeve të protokolleve;

- liria e autoriteteve kufitare për të përfunduar protokolle të veçanta dypalëshe me njëri-tjetrin, veçmas;

- e drejta e policisë së kufirit të shtetit fqinj për të kryer kontrolle në territorin e shtetit vendas në zonë;

- e drejta e autoriteteve doganore për të krijuar një sportel të vetëm shërbimi në zonë;

- e drejta e autoriteteve fitosanitare, veterinare, sanitare dhe shëndetësore antiepidemiologjike dhe e çdo autoriteti tjetër të caktuar nga çdo palë kontraktuese për të kryer kontrolle në zonën e territorit të shtetit vendas dhe të pranojnë respektivisht certifikatat dhe kontrollet reciproke.

Palët kontraktuese bien dakord të publikojnë në faqen e internetit të gjitha dokumentet dhe procedurat që kërkohen nga autoritetet kufitare dhe nga administruesit e infrastrukturës për një kalim të qetë të kufirit.

Palët kontraktuese bien dakord që administruesit e tyre të infrastrukturës hekurudhore të përgatisin dhe të hartojnë një deklaratë të përbashkët të rrjetit që përmban:

- procedura jodiskriminuese të pranimit në rrjet për transportuesit hekurudhorë për të hyrë në zonë;

- procedura e *one-stop-shop* për të lehtësuar pagesat e shërbimeve të infrastrukturës;

- procedura e përcaktimit të rrugëkalimeve;

- procedura jodiskriminuese për tarifën e infrastrukturës dhe faturimin e shërbimeve, që sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe lehtësi në bërjen e pagesave të mundshme nga transportuesit hekurudhorë.

Neni 3

Zona

Zona do të përfshijë:

a) mjediset ku autoritetet kufitare të shtetit fqinj mund të kryejnë funksionet e tyre, shinat dhe linjat, stacionet e mallrave dhe të udhëtarëve, magazinat, objektet e pritjes për udhëtarët dhe ndërtesat dhe pajisjet e tjera;

b) trenat që lëvizin ndërmjet seksioneve të linjave ose stacioneve të caktuara gjatë të cilave autoritetet kufitare kryejnë detyrat e tyre.

Dispozitat e përgjithshme, objektivat dhe parimet e përmendura në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje janë të vlefshme për zonën.

Në këtë marrëveshje zona përfshin:

a) stacionet kufitare Tuzi dhe Bajzë;

b) seksionet kufitare midis dy stacioneve;

c) seksionin midis stacionit të Tuzit dhe Bajzës për kontrollin e mjeteve të udhëtarëve në lëvizje;

d) seksionin midis stacionit të Tuzit dhe Bajzës për lëvizjen e trenave të mallrave.

Në kushtet e kësaj marrëveshjeje stacioni i përbashkët kufitar do të jetë Tuzi.

Autoritetet kufitare të palëve kontraktuese janë të lira për të zgjeruar zonën për qëllimet e tyre në përputhje me dispozitat e përgjithshme, objektivat dhe parimet e përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, duke lidhur protokolle dypalëshe të mëtejshme.



Neni 4 **Transporti kufitar në zonë**

Në zonë, ligjet dhe rregulloret e shtetit fqinj janë të vlefshme në lidhje me kalimin e kufirit të personave, të mallrave (importin, eksportin dhe tranzitin), sipas parimeve të mëposhtme:

a) personat dhe mallrat do të trajtohen me të njëjtat procedura dhe do të kenë të njëjtat pasoja ligjore sikur të ishin në territorin e shtetit fqinj;

b) Veprimet e tilla, si ato policore, doganore apo ndërhyrje të tjera, si dhe ndalimi i personave dhe bllokimi i mallrave duhet të jenë në përputhje me protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve përkatëse të palëve kontraktuese.

Sipas protokolleve të veçanta, autoritetet e kufirit mund t'ia transferojnë kompetencat e tyre të kalimit kufitar autoriteteve kufitare të shtetit tjetër në mënyrë që të arrihen objektivat dhe parimet e përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Për sa kohë që autoritetet kufitare të shtetit fqinj nuk ia kanë transferuar kompetencat e tyre të kalimit kufitar autoritetit kufitar të shtetit vendas, autoritetet kufitare të shtetit vendas do të kryejnë procedurat e përcaktuara, përpara se autoritetet kufitare të shtetit fqinj të kryejnë procedurat e tyre. E njëjta gjë do të jetë e vlefshme edhe nëse personeli zyrtar i shtetit dalës refuzon kryerjen e procedurave dhe kontrollin kufitar.

Në një kohë që procedura e transportit kufitar të shtetit fqinj ka filluar, kompetencat e autoriteteve të shtetit vendas tashmë kanë përfunduar, përveç kur kanë ato arsye ligjore për të ndërhyrë, por vetëm me miratimin e autoriteteve përkatëse të shtetit fqinj.

Të drejtat në lidhje me azilin politik dhe të drejtat e njeriut në shtetin vendas do të mbeten në fuqi.

Personeli zyrtar i autoriteteve kufitare të shtetit fqinj, duke kryer funksionet e tyre në lidhje me kalimin kufitar në shtetin vendas do të jetë përgjegjës vetëm ndaj autoriteteve të shtetit të tyre.

Personeli zyrtar i autoriteteve kufitare të shtetit fqinj do të ketë të drejtë të kryejë funksione në zonën e shtetit vendas. Personeli është i detyruar të informojë autoritetet kompetente kufitare të shtetit vendas mbi veprimet dhe masat e ndërmarra. Shteti vendas është i detyruar të njoftojë menjëherë personelin e autoritetit kufitar respektiv të shtetit fqinj për vendimin e tij.

Në mënyrë që të arrihet një kontroll kufitar sa më i shpejtë, personeli zyrtar mund të negociojë dorëzimin e detyrave, sipas përcaktimeve të nenit 4, paragrafi 7 të kësaj marrëveshjeje. Në një rast të tillë personeli i autoritetit përkatës në shtetin hyrës do të ketë të drejtën për të arrestuar një person dhe/ose konfiskimin e mallrave, vetëm kur të ketë mbaruar kontrolli kufitar i shtetit dalës. Nëse personeli i autoritetit përkatës në shtetin hyrës do ta shohë të përshtatshme, atëherë personeli i shtetit dalës do të jetë i detyruar që të dorëzojë personat ose mallrat e personelit përkatës të shtetit dalës, përpara përfundimit të kontrollit kufitar.

Personeli i palëve kontraktuese është i detyruar të bashkëpunojë me njëri-tjetrin.

Personeli zyrtar i shtetit fqinj ka të drejtën e dërgimit falas të sendeve vetjake, të cilat janë ndaluar përkohësisht në zonë, si dhe burimet financiare të mbledhura në zonë, përmes kufirit shtetëror në territorin e shtetit të tij.

Sendet vetjake të kapura dhe të konfiskuara gjatë kontrolleve të kryera në dalje dhe të kthyera nga personeli zyrtar i shtetit fqinj, nuk do të jenë subjekt i inspektimit kufitar nga ana e personelit të shtetit vendas.

Protokollet ndërmjet autoriteteve të palëve kontraktuese do të përcaktojnë më hollësisht realizimin e kontrollit kufitar.

Neni 5

Kontrolli kufitar në bordin e trenave të udhëtarëve

Kontrolli kufitar i trenave të udhëtarëve do të kryhet bashkërisht, si në trenat që janë në lëvizje ose të ndaluar në stacionet kufitare nga personeli i autoriteteve kufitare të palëve kontraktuese.

Siguria e jashtme në stacionet kufitare të përbashkëta do të sigurohet në përputhje me rregulloret e shtetit vendas.

Neni 6

Kontrolli kufitar në trenat e mallrave

Kontrolli kufitar për trenat e transportit të mallrave do të kryhet në stacionin e përbashkët kufitar në zonë nga autoritetet kufitare të palëve kontraktuese.

Siguria e jashtme në stacione të përbashkëta kufitare do të sigurohet në përputhje me rregulloret e shtetit vendas.

Çdo person i kapur nga autoritetet kufitare të palëve kontraktuese në kalimin e paligjshëm të kufirit, në trenat e mallrave në stacionin e përbashkët kufitar, do të jetë subjekt i ligjeve të autoritetit të shtetit vendas.

Neni 7

Shkëmbimi i informacionit

Gjatë kohës në detyrë, personeli zyrtar mund të shkëmbejë vetëm informacion të paklasifikuar, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. Shkëmbimi i informacionit do të kryhet mbi bazën e protokolleve të veçanta të lidhura ndërmjet autoriteteve kufitare përkatëse të palëve kontraktuese.

Neni 8

Statusi i personelit zyrtar

Gjatë kohës në detyrë, personeli i autoriteteve kufitare ka të drejtën e hyrjes së lirë në zonën e shtetit fqinj, me uniformë me ose pa armë. Personeli i shtetit fqinj merr të njëjtën mbrojtje dhe mbështetje si personeli i shtetit vendas.

Për personelin e tij, ligjet dhe rregullat e shtetit fqinj janë të vlefshme në zonë.

Personeli i tij zyrtar duhet të pajiset me karta të veçanta identifikimi për të vepruar brenda zonës. Procedura e lëshimit përcaktohet në nenin 10 të kësaj marrëveshjeje.

Nëse dikush nga personeli i tij vritet ose plagoset, i humbin gjërat personale që i mban me vete (armët, uniforma etj.), gjatë detyrës, zbatohen ligjet dhe rregullat e shtetit fqinj.

Çështje të tjera që lidhen me personelin zyrtar do të rregullohen me protokolle të veçanta ndërmjet autoriteteve përkatëse kufitare.

Veprat apo shkeljet penale të kryera brenda zonës, të drejtuara kundër personelit zyrtar apo hekurudhor të shtetit fqinj që janë në detyrë do të trajtohen në përputhje me legjislacionin e shtetit vendas, sipas të njëjtave kushte, sikur t'i kishin ndodhur personelit zyrtar apo hekurudhor të shtetit vendas. Procedurat përcaktohen me protokolle të veçanta.

Personeli zyrtar dhe hekurudhor i shtetit fqinj gjatë detyrës brenda në zonë duhet të ketë të veshur uniformën zyrtare dhe/ose simbole të dukshme zyrtare.



Neni 9

Lehtësitë e kalimit kufitar

Në trena, ndërmarrjet hekurudhore janë të detyruara të sigurojnë kabina të rezervuara, pa pagesë, për personelin zyrtar në detyrë.

Në lidhje me përdorimin e hapësirës dhe të dhomave në zonë që i caktohen autoriteteve kufitare të shtetit fqinj, autoritetet kufitare do të lidhin kontratat përkatëse, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

Godinat zyrtare dhe mjetet duhet të identifikohen me mbishkrimin dhe me simbolin apo stemat kombëtare. Mbishkrimet në mjediset e zyrave shkruhen në gjuhët zyrtare të palëve kontraktuese dhe në gjuhën angleze, duke mbishkruar fillimisht gjuhën zyrtare të shtetit vendas.

Objektet e përdorura gjatë ushtrimit të detyrës nga personeli zyrtar dhe hekurudhor i shtetit fqinj në ose jashtë territorit të shtetit vendas nuk janë subjekt i deklarimit doganor dhe detyrimeve doganore ose detyrimeve të tjera.

Autoritetet kufitare janë të lira të lidhin protokollet përkatëse mbi çështjet e përmendura në këtë nen, në përputhje me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

Karta e identitetit për personelin zyrtar dhe hekurudhor

Në përputhje me nenin 8, paragrafin 3 të kësaj marrëveshjeje, kartat zyrtare të identitetit lëshohen nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese për një periudhë njëvjeçare. Afati i vlefshmërisë duhet të zyrtarizohet nga ana e organeve kompetente të të dyja palëve kontraktuese.

Autoriteti lëshues është i detyruar të shfuqizojë menjëherë kartën e identitetit në përfundim të arsyeve për të cilat ajo është lëshuar dhe është i detyruar të njoftojë menjëherë me shkrim autoritetet kompetente të shtetit fqinj.

Personeli hekurudhor që merr pjesë në organizimin e operacioneve të transportit, pa kartë identiteti, duhet të regjistrohet në listën e personelit. Modeli i listës tregohet në programin nr. 1.

Në rastin e paragrafit 3 të këtij neni, autoritetet që lëshojnë dokumentet duhet të informojnë menjëherë me shkrim autoritetet përkatëse të shtetit fqinj.

Personat e përmendur në listën e personelit, pa kartë identiteti, kanë të drejtë të kalojnë kufirin shtetëror brenda në zonë, kur janë në detyrë dhe të qëndrojnë në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Të gjithë personat, emrat e të cilëve janë në listën e personelit, duhet të mbajnë pasaportë të vlefshme.

Neni 11

Pajisjet e telekomunikacionit

Shteti vendas duhet të japë leje, pa pagesë, për instalimin e pajisjeve të telekomunikacionit që janë të domosdoshme për punën e autoriteteve kufitare të shtetit fqinj në shtetin vendas, si dhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet e duhura të shtetit fqinj.

Instalimi, mirëmbajtja dhe operimi i mjeteve të telekomunikacionit do të jenë subjekt i protokolleve ndërmjet autoriteteve përkatëse.

Neni 12
Gjuha

Në stacionin e përbashkët kufitar, në stacionin kufitar, si dhe në linjën hekurudhore kufitare, gjatë komunikimit të personelit zyrtar dhe hekurudhor do të përdoren në mënyrë të barabartë gjuhët që janë në përdorimin zyrtar në të dyja shtetet.

Bisedat telefonike, komunikimet me gojë dhe/ose me shkrim që lidhen me transportin hekurudhor do të zhvillohen në gjuhët që janë në përdorimin zyrtar në të dyja shtetet.

Neni 13
Fondet e mbledhura zyrtarisht

Personeli hekurudhor ka të drejtë të mbajë shumat e mbledhura për shërbimet hekurudhore përgjatë kufirit në të dyja drejtimet.

Neni 14
Komisioni i kalimit kufitar

Palët kontraktuese do të krijojnë komisionin e kalimit kufitar, me qëllim që të garantojnë objektivat e mëposhtëm:

- të drejtë hyrjeje jodiskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore brenda zonës;
- krijimi i kushteve për konkurrencë të ndershme;
- gjykim ndërmjet administruesve të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore në lidhje me deklaratën e rjetit kufitar;
- gjykim midis ndërmarrjeve hekurudhore që përdorin shërbimet hekurudhore kufitare;
- zgjidhje për problemet që lindin nga bashkëpunimi i autoriteteve kufitare në zonë;
- përmirësimi i shërbimeve kufitare;
- interpretimi i dispozitave në këtë marrëveshje.

Aktivitetet e komisionit të kalimit kufitar nuk përjashtojnë ndërhyrje ose zgjidhje diplomatike të çështjeve në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet partnerëve kontraktues.

Komisioni i kalimit kufitar do të përfshijë përfaqësues të të gjitha organeve shtetërore përgjegjëse për kontrollin kufitar, ministritë përgjegjëse për transportin, drejtoritë e hekurudhave dhe hekurudhat e të dyja shteteve.

Komisioni i kalimit kufitar do të mbledhet të paktën një herë në vit, në mënyrë alternative në territorin e njërit apo tjetrit shtet dhe nëse është e nevojshme më shpesh, me kërkesë të njëres prej palëve kontraktuese.

Metoda e punës së komisionit të kalimit kufitar përcaktohet nga rregullat e procedurës që do të aprovohen gjatë takimit të parë të tij.

Neni 15
Vlefshmëria

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar, me mundësinë e përfundimit të saj me nismën e secilës nga palët kontraktuese.

Vlefshmëria e marrëveshjes do të përfundojë gjashtë muaj pas ditës së marrjes së notës diplomatike, përmes së cilës pala tjetër kontraktuese njofton përfundimin e marrëveshjes.



Neni 16 Hyrja në fuqi

Marrëveshja i nënshtrohet ratifikimit dhe hyn në fuqi 30 ditë pasi palët kontraktuese të kenë informuar njëra-tjetrën, përmes notave diplomatike, se ratifikimi është kryer në përputhje me dispozitat e legjislacionit të tyre kombëtar.

Protokollet ndërmjet autoriteteve të veçanta kufitare të përcaktuara në këtë marrëveshje, duhet të miratohen brenda afatit prej 90 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për organizimin e trafikut kufitar hekurudhor midis të dyja vendeve, e nënshkruar më 16 maj 2006 në Podgoricë pushon së qenuri e vlefshme nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në, më 20_, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze dhe të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PROGRAMI NR. 1

LISTA E PERSONAVE QE KALOJNË KUFIRIN SHETETËROR PËR QËLLIME ZYRTARE¹

Në stacionin e përbashkët kufitar ose në stacionin kufitar (fshije nëse është e panevojshme)

Hekurudha _____ më _____

Në orën _____, me _____

Kjo listë konsiderohet si shtojcë e lejes zyrtare për kalimin e kufirit shtetëror nr. _____ që i përket _____

Numri rendor	Emri dhe mbiemri	Data dhe vendi i lindjes	Funksioni	Numri i kartës së identitetit	Vërejtje

Data _____

Drejtuesi i stacionit _____

Vërtetuar nga autoriteti shtetëror

Vërtetuar nga autoriteti shtetëror

Në dalje _____

në hyrje _____

¹ Lista është përgatitur nga drejtuesi i stacionit kufitar.

VENDIM
Nr. 493, datë 1.8.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË MENAXHIMIT, OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË TERMINALIT
LINDOR NË PORTIN E DURRËSIT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “EMS SHIPPING AND
TRADING GMBH”, GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pikat 1 e 3 dhe 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së terminalit lindor në Portin e Durrësit, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Koncesioni do të jetë i formës BOT (ndërtim-shfrytëzim-transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 8.3 (tetë pikë tri) pikësh, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “EMS Shipping and Trading GmbH”, Gjermani.
4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 494, datë 1.8.2012

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “KOLEGJI
PROFESIONAL I SPORTEVE, FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 43, 44 e 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier”, në emër të shoqërisë “Akademia e Sporteve, Fier” sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në këtë qytet.
2. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier” të ketë njësi përbërëse organizative Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, i cili do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë, në “Edukim fizik dhe sporte”.



3. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier” të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë, në “Edukim fizik dhe sporte”, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike, që realizohet me 180 kredite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Edukim fizik dhe sporte”.

4. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë i ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi e programe dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. “Kolegji Profesional i Sporteve, Fier”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programit të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 495, datë 1.8.2012

**PËR DHËNIE TË ÇMIMEVE DHE SHPËRBLIMEVE SHKENCORE PERSONAVE QË
KANË PUNUAR PËR KRIJIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E SISTEMEVE ELEKTRONIKE
NË FUSHËN E DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimin publik të z. Aristotel Agaraj për krijimin e sistemit elektronik “One-Stop Shop-Sistemi i Noterisë” dhe për kalimin në pronësi, pa kundërshtëpërblim, të këtij sistemi Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim vënien në përdorim në shërbim të publikut.

2. Vlerësimin publik të z. Xhevair Llakaj për krijimin e portalit elektronik të kërkesave për shërbime pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe vënien e këtij sistemi në shërbim të publikut.

3. Vlerësimin publik të z. Agim Kasaj për ndërtimin e portalit elektronik të gjykatave dhe për përmirësimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

4. Ministri i Drejtësisë t’i akordojë z. Aristotel Agaraj çmimin “Mirënjohje publike”, nëpërmjet një ceremonie publike që do të zhvillohet në Ministrinë e Drejtësisë.

5. Z. Aristotel Agaraj t’i jepet një shpërblim në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

6. Z. Xhevair Llakaj t'i jepet një shpërblim në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

7. Z. Agim Kasaj t'i jepet një shpërblim në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

8. Çmimi dhe shpërblimet shkencore të jepen brenda një muaji nga miratimi i këtij vendimi.

9. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Masa e shpërblimit, e përcaktuar në pikën 5, të përballohet nga shpenzimet korente të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Masa e shpërblimit, e përcaktuar në pikat 6 dhe 7 të këtij vendimi, të përballohen nga fondi i veçantë i planifikuar në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

10. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 496, datë 1.8.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË USHTRIMIT TË SË
DREJTËS SË AKSESIT PËR PERSONAT JURIDIKË/FIZIKË, VENDAS APO TË HUAJ,
NË SISTEMIN ELEKTRONIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 69 e 76 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme dhe të marrjes së ekstrakteve të të dhënave nga regjistri elektronik personat juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, të cilët vërtetojnë interesin legjitim dhe përmbushin kriteret e parashikuara në këtë vendim. Këto subjekte kategorizohen në bazë të shërbimeve të ofruara nga sistemi elektronik, në përputhje me parashikimet në vijim.

2. Shërbimet elektronike të ofruara nga sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndara sipas përdoruesve, janë:

a) Për sistemet e informacionit që ofrojnë “Informacion *on-line*” të përgjithshëm:

i) Shërbimi A1 “Konsultim i kartelës dhe i të dhënave të tjera të pasurive të paluajtshme”.

Përdoruesit:

A1.1 Prokuroria e Përgjithshme;

A1.2 Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore;

A1.3 Ministria e Brendshme;

A1.4 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

A1.5 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

A1.6 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

A1.7 Noterët;

A1.8 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;



A1.9 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

ii) Shërbimi A2 “Lëshim kopjeje elektronike të kartelës, hartës treguese ose pjesë të saj”.

Përdoruesit:

A2.1 Prokuroria e Përgjithshme;

A2.2 Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore;

A2.3 Ministria e Brendshme;

A2.4 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

A2.5 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

A2.6 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

A2.7 Noterët;

A2.8 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

A2.9 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

iii) Shërbimi A3 “Kërkesë për kopje elektronike të dokumenteve të pasurive të paluajtshme për çdo faqe”.

Përdoruesit:

A3.1 Prokuroria e Përgjithshme;

A3.2 Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore;

A3.3 Ministria e Brendshme;

A3.4 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

A3.5 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

A3.6 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

A3.7 Noterët;

A3.8 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

A3.9 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

b) Për sistemet e informacionit që ofrojnë “Shërbime *on-line* me mbështetje” nga operatori i ZRPP-së:

i) Shërbimet:

B1 Lëshim i certifikatave të pasurisë;

B2 Kërkesë për regjistrim të pronësisë së pasurive të paluajtshme;

B3 Kërkesë për regjistrim të pjesëtimit me ndarje ose bashkimit të pasurive të paluajtshme;

B4 Kërkesë për informacion zyrtar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për individët dhe institucionet;

B5 Kërkesë për lëshim të kopjes së certifikatës së pasurive të paluajtshme;

B6 Kërkesë për saktësim të kufijve;

B7 Kërkesë për përgatitjen e dokumenteve në gjykatë ose organ tjetër administrativ;

B8 Kërkesë për regjistrim për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje të pasurive të paluajtshme;

B9 Kërkesë për regjistrim hipoteke, hipotekë ligjore;

B10 Kërkesë për regjistrim për fshirje hipoteke, hipotekë ligjore;

B11 Kërkesë për regjistrim për fshirjen e një vendimi gjykate, të një akti administrativ;

B12 Kërkesë për regjistrim servituti, marrëveshje kufizuese;

B13 Kërkesë për regjistrim për fshirjen e një servituti, marrëveshje kufizuese;

B14 Regjistrim i kërkesave për heqjen dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme;

B15 Regjistrim i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi;

B16 Kërkesë për korrigjimin e gabimeve materiale në kartelë;

B17 Lëshim vërtetimi pronësie (negativ);

B18 Lëshim vërtetimi pronësie;

B19 Regjistrim fillestar i pasurive të paluajtshme në zonat urbane pa rilevim e përditësim të pasurisë nga zyrat e regjistrimit të pasurive;

B20 Regjistrim fillestar i pasurive të paluajtshme në zonat urbane me rilevim e përditësim të pasurisë nga zyrat e regjistrimit të pasurive;

B21 Regjistrim fillestar i veçantë i pasurive të paluajtshme në zonat rurale;

B22 Regjistrim provizor i karabinasë.

Përdoruesit:

B (1-22). 1 Të gjithë përdoruesit e interesuar.

II) Shërbimet:

B23 Shërbime për veprimet e bankave e institucioneve të tjera kredidhënëse për kredi me vlerë deri 1 000 000 (një milion) lekë;

B24 Shërbime për veprimet e bankave e institucioneve të tjera kredidhënëse për kredi me vlerë 1 000 001 (një milion e një) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

B25 Shërbime për veprimet e bankave e institucioneve të tjera kredidhënëse për kredi me vlerë mbi 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Përdoruesit:

B. (23-25) Bankat dhe institucionet e tjera kredidhënëse.

3. Personat fizikë, vendas apo të huaj, përfitojnë shërbimet që lidhen me sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme, të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, në rast se vërtetojnë interesin e ligjshëm lidhur me pasurinë për të cilën interesohen.

4. Dhënia e aksesit në sistemin elektronik për personat fizikë, vendas apo të huaj, bëhet kundrejt pagesës së tarifës së përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave e në përputhje me rregullat e parashikuara nga kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë. Subjektet e parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën për ofrimin e aksesit në sistem nëpërmjet plotësimit të formularit, i cili parashikohet në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Procedurat që ndiqen për dhënien e së drejtës së aksesit personit fizik të interesuar, vendas apo të huaj, janë:

a) Personi informohet për adresën në internet të aplikacionit *software* që akseson regjistrin elektronik, si dhe për kredencialet e hyrjes në këtë regjistër (kodi personal dhe fjalëkalimi), sipas formës së parashikuar në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Procedurat e detajuara të njoftimit përcaktohen nga kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë;

b) Administratorët e sistemit kujdesen për garantimin e pamundësisë së manipulimit të kredencialeve të regjistrit elektronik, duke siguruar ndryshimin nga (dhe vetëm) përdoruesi fundor i fjalëkalimit fillestar, dhe ruajtjen e fshehtësisë së tij.

6. Në çdo rast, e drejta e aksesit në sistem për subjektet e interesuara jepet dhe ushtrohet në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit, për dokumentin elektronik, si dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Me qëllim respektimin e kushteve dhe të procedurave të parashikuara në ligjin në fuqi për pasuritë e paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë merr masat e mëposhtme:

a) merr masa për funksionimin *on-line* të sistemit 24 orë në 7 ditë;

b) verifikon çdo ditë sistemin elektronik;



c) kryen konsultime me stafin e punonjësve të cilët merren me aspektet e administrimit të regjistrimit elektronik;

ç) merr masa të tjera të nevojshme të sugjeruara nga punonjësit e parashikuar në shkronjën “c”.

8. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
FORMULAR PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR AKSESIN NË SISTEMIN
ELEKTRONIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Të dhënat e kërkuarit

Emër, atësi, mbiemër _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Dokumenti i identifikimit (kopja i bashkëlidhet formularit) _____

Qëllimi i paraqitjes së kërkesës _____

Të dhënat e pasurisë së pasurisë së paluajtshme _____

Nënshkrimi i kërkuarit (emër, mbiemër, firmë) _____

Nënshkrimi i personit autorizues, operator i pasurive të paluajtshme (emër, mbiemër, funksioni, firmë) _____

Data e paraqitjes së kërkesës _____

ANEKS 2

NJOFTIMI PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË AKSESIT



(Logo e miratuar ZQRPP)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTËSHME

I nderuar Z. Znj. _____

Përdorimi i teknologjisë së informacionit në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme mbështetet në modelin e ngritjes së rrjeteve të integruara, me të gjitha garancitë e sigurisë së ruajtjes dhe përpunimit të informacionit sipas përcaktimeve ligjore të së drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te komuna Farkë, Tiranë, të pronës nr. 193, me emërtim “Group Depo M (Ish-Reparti Ushtarak nr. 5011/53)”, në Lundër, Tiranë, sipas formularit standard të inventarizimit, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për krijimin e Qendrës së Shërbimeve të Integruara, zyra administrate, stacion policie, stacion zjarrfikës, qendër shëndetësore, çerdhe e kopsht.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 193, me emërtim “Group Depo M (Ish-Reparti Ushtarak nr. 5011/53)”, Lundër, Tiranë.

3. Komunës Farkë, Tiranë, i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr. 193, me emërtim “Group Depo M (Ish-Reparti Ushtarak nr. 5011/53)”, në Lundër, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim te të tretë.

4. Dorëzimi i mjediseve dhe i truallit funksional të pronës të bëhet pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuara në këtë pronë.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryetari i komunës Farkë, Tiranë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

MINISTRIA E MBROJTJES

Komuna Farkë, Tiranë

Fusha e përdorimit të pronës: për mbrojtjen kombëtare

A			B				C			
	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në M ² ose MI	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
193	ZK nr.2529	Nr.867/4	Grup depo M (Ish- Rep.Usht. 5011/53)		Lundër, Farkë, Tiranë	28256.7 M ²	Për mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes Brigada logjistike	Brigada logjistike rep.usht. nr.4303	Identifikuar me të dhënat e formularit standard të planvendosjes, të dërguar nga KM me nr. 3212, datë 2.6.2009 dhe Br.1, nr. 4082, datë 15.9.2010
				Depo		330.1				
				Park telaj		476.7				
				Park telaj		195				
				Park telaj		287.5				
				Depo		809.1				2-katëshe
				Trup-rojë		48.6				Dhëne familjarëve
				Zyra komande		129				
				Depo		141.9				
				Depo		165.1				
				Zyrë komande		120.9				2 kate



				Depo nr.1		199				
				Depo nr.2		211.3				
				Park automjete		324.7				
				Oficinë		154.7				
				Pikë hapje		115.8				Dhënë familjarëve
				Depo		809.1				2 kate
				Truall		23738.2				

VENDIM
Nr. 499, datë 1.8.2012**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 432, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË**
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen më të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2012.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË FUNKSIONEVE,
PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT

Nivelet e klasifikimit	Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve	Klasa për çdo nivel klasifikimi	Paga bazë mujore për klasë në lekë	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për gradë në %
1	2	3	4	5	6
I	Punonjës mbështetës	I.1	21000	1%	2%
		I.2	23 000	1%	2%
		I.3	26 500	1%	3%
		I.4	29500	1%	5%
		I.5	38100	1%	6%
		I.6	39000	1%	6%
II	Punonjës të nivelit zbatues	II.1	43100	1%	8%
		II.2	46200	1%	12%
		II.3	47700	1%	12%



III	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	III.1	51200	1%	14%
		III.2	52800	1%	16%
IV	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	IV.1	56800	1%	20%
		IV.2	64300	1%	20%
Jashtë klasifikimit	Inspektor i Përgjithshëm në SHISH		126000	0%	0%

VENDIM
Nr. 500, datë 1.8.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM, NË MINISTRINË E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr. 10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”, të nenit 4 pika 2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 718, datë 23.6.2009, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 - b) Lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit civilë inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 - c) Lidhja nr. 3 “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, e përmendur në pikën 8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2012.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES TË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Nr.	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4
1	Asistent	Ndihmës specialist në provë në trupën operacionale	38000	6500
2	Agjent	Ndihmës specialist në trupën operacionale	41500	8000
3	Agjent i I-rë	Drejtues grupi/ndihmës specialist në trupën operacionale	46500	8000
4	Hetues	Specialist hetimi në nivel vendor. Specialist hetimi në nivel vendor në provë	56000	8000
5	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel vendor	68700	8000
	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel qendror. Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	78000	10000
6	Drejtues	Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor Shef sektori në nivel qendror	85000	10000
7	Drejtues i I-rë	Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor Drejtor drejtorie në nivel qendror	96000	10000
8	Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm	Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm (Drejtor i Departamentit të Hetimit	98500	15000



9	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	107300	20000
---	------------------------	------------------------	--------	-------

Lidhja nr. 2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË INSPEKTUES DHE
MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Nr.	Klasifikimi i niveleve	Funksionet organike	Kategoria e pagës	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa e pozicionit	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4	5	6	7
1	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit	II-b	1	2%	90200	
2	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor në nivel qendror (për shërbimet mbështetëse)	III-a	1	2%	72900	
3	Punonjës të nivelit bazë drejtues	Shef sektori në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-a	1	2%	72900	5000
4	Punonjës të nivelit bazë zbatues	Inspektor në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-b	1 ose 2	2%	55500	5000
		Specialist në nivel qendror	III-b	1 ose 2	2%	55500	
		Specialist trajnimi në nivel qendror për punonjësit e SHKB-së	IV-a	1 ose 2	2%	44300	5000
		Specialist në nivel qendror	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	44500	
		Specialist në nivel qendror	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	34200	

Lidhja nr. 3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11000 lekë
3	<i>Bachelor</i> Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10000 lekë

VENDIM

Nr. 501, datë 1.8.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 413, DATË 26.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS, SI DHE TË
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AUTORITETIT TË
AVIACIONIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr. 10 233, datë 11.7.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 413, datë 26.5.2010, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Lidhja nr. 3, e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lidhja nr. 4, e përmendur në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. “Specialistët”, “përgjegjësit e sektorit” apo “drejtorët” në Autoritetin e Aviacionit Civil, që punojnë në pozicione pune që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së këtij institucioni dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë “për kushte pune” prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh në muaj mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhja nr.3

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AUTORITETIN
E AVIACIONIT CIVIL**

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	1	2%	0	107.300	15.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	1	2%	0	90.200	15.000
Drejtor Drejtorie	II-b	1	2%	0	90.200	0
Përgjegjës sektori. Inspektor	III-a	1	2%	0	72.900	0
Përgjegjës sektori.	III-a/1	1	2%	0	63.700	0
Inspektor	III-b	1	2%	0	55.500	0
Specialist	III-b	1 ose 2	2%	0	55.500	0
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	0	44.300	0

Lidhja nr.4

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Master i shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10000 lekë

VENDIM
Nr. 502, datë 1.8.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 20 të ligjit nr. 9410, datë 12.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimin nr. 839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, lidhja nr. 1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 5/1 riformulohet, si më poshtë vijon:

“5/1 Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë “për kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PAGA BAZE SIPAS GRADES DHE VITEVE TE SHERBIMIT PER USHTARAKET AKTIVE TE FORCAVE TE ARMATOSURA

OFICERE	Vitet e sherbimit														
	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj. Lejtnant (Admiral)															156000
Gj. Major (Nenadmiral)														146000	149000
Gj. Brigade (Kunderadmiral)													116000	117000	117000
Kolonel (Kapiten i rangut I-re)											92000	93500	95500	97400	99000
Nenkolonel (Kapiten i rangut II-re)									72700	74100	75300	76650	77800	79200	80400
Major (Kapiten i rangut III-re)							57300	58300	59300	60300	62200	63200	64500		
Kapiten (Kapiten lejniant)				51500	52000	52300	53000	53800	54300	55300	55850				
Toger (Lejniant)			47600	48800	49700	51000	51500								
Nentoger (Nenlejniant)	44000	45000	46000	46500	46700	47600									
Vitet e sherbimit															
NENOFICERE	Vitet e sherbimit														
	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/Kapter											52400	53500	55100	56200	57200
Kapter								44700	46200	47000	47600	49200	51300		
Rreshier						39500	41200	43400	44700	46200	47000				
Tetar				37700	38100	39000	39700	40500	41350	42300	43200				
Nentetar	32300	33100	34300	35500	37400	38700									
Vitet e sherbimit															
USHTARE PROFESIONISTE	Vitet e sherbimit														
	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/ detar profesionist II	32260	33550	34600	36100	37400										
Ushtar/ detar profesionist I	29500	31000													
USHTARE TE SHERBIMIT TE DETYRUESHEM E STUDENTE USHTARAKE															
Vitet e sherbimit															
USHTAR REKRUT II/ Detar II	Vitet e sherbimit														
	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/ Detar II	3000														
Ushtar rekrut I/ Detar I	2500														
Studente ushtarak	2500														

VENDIM
Nr. 503, datë 1.8.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 438, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA
ZJARRI DHE SHPËTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhja nr.1

**Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri
dhe Shpëtimit**

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi
1	2	3	4
Bazë	Agjent	36900	7000
	Agjent i I-rë	40100	7000
	Asistent	42750	8000
	Asistent i I-rë	44350	8000
	Kryeasistent	46900	8000
I Mesëm	Nëninspektor	51000	6000
	Inspektor	54800	6000
	Kryeinspektor	64000	6000
I lartë	Nënkomisar	73000	6000
	Komisar	84100	6000
	Kryekomisar	96500	6000
Madhor	Drejtues	107300	
	Drejtues i I-rë	117800	

VENDIM
Nr. 504, datë 1.8.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1135, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 32 të Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr. 804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. “Specialistët”, “përgjegjësit e sektorit” apo “drejtorët” në Policinë e Shtetit, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë “për kushte pune” prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2012.
 3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhja Nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi																																																																																																																																																						
Niveli	Grada	Paga bazë për grade	Në funksione organike për hetimin e krimeve kundër krimit të organizuar e Oficerët e Policisë. Specialistë të policisë në zonë. Në funksione organike të mbrojtjes së mirënjohjes dhe dhunës në familje. Në funksione të drejtorisë së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërkombëtar	Në funksione të Forcës së Posaçme & Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimit e Rënda	Në funksione të sigurisë publike. Policia rrugore. Qendra e Emergjencave e sallave operative. Rualtja e sigurisë e objekteve.	Në funksion e ndalim e paraburgimi	Në funksione organike të Policisë kufitare & migracionit	Në funksione operuese të Forcave speciale (Kom rep, Zv/k rep, Shef Shtabi në RENE/A. Reparti Helikoptereve Njësia Antieksploziv. Njësia Negociatore & Njësia e Levizshme Teritoriale për Kufirin e Migracionin, si dhe reparti RESI)	Në funksione operuese të Forcave speciale (Kom rep, Zv/k rep, Shef Shtabi në RENE/A. Reparti Helikoptereve Njësia Antieksploziv. Njësia Negociatore & Njësia e Levizshme Teritoriale për Kufirin e Migracionin, si dhe reparti RESI)	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të shërbimit mbështetës e administrativë në Policinë e Shtetit	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së deshmëtarëve dhe bashkëpunetorëve të drejtësisë.	Në funksione të drejtorisë

VENDIM
Nr. 505, datë 1.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1061, DATË 8.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 10 032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1061, datë 8.7.2010 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2012, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2012 për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhja nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e sherbimi		
			Në funksion të policisë të regjimeve të jashtme, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Grupet e ruajtjes së objekteve në D.P.Burgjeve.	Në funksion të policisë të regjimeve të brendshme në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe grupet e transferim shoqërimit në I.E.V.P dhe në D.P.Burgjeve.	Në funksion të policisë në drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
1	2	3	4	5	6
Bazë	Nëninspektor	36000	4000	8000	
	Inspektor	39600	4000	8000	
	Kryeinspektor	44800	4000	8000	2000
				8000	
I Mesëm	Nënkomisar	54600	4000	8000	2000
	Komisar	59300	4000	8000	2000
	Kryekomisar	82500	4000	8000	2000
I lartë	Drejtues	94800			6500
	Drejtues i I-rë	98000			10000

VENDIM
Nr. 506, datë 1.8.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE
NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr. 1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhja nr.1

Niveli i pagës për gradë sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës

Roli i punonjësve sipas gradave		Grada	Paga bazë për gradë
Për punonjësit oficerë	Madhor	Gjeneral garde	110100
	I lartë	Kolonel	95850
		N/Kolonel	84600
		Major	72500
	I mesëm	Kapiten	62000
		N/Kapiten	58700
	I ulët	Toger	55600
		N/Toger	52500
Për punonjësit nënoficerë	Madhor	Kryekapter	44500
	I lartë	Kapter	42300
		Kapter shtabi	41300
		Kapter mjeshtër	40300
	I mesëm	Kapter i parë	39800
		Kapter i dytë	39300
		Kapter i tretë	38800
	I ulët	Kapter i katërt	38000
		Rreshter	36900

VENDIM

Nr. 507, datë 1.8.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 748, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 pika 2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen nr. 1 me të njëjtin numër dhe emërtim, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Në pikën 5, fjalët "...Këshillin e Administrimit...", shfuqizohen.

3. Pika 9 riformulohet, si më poshtë vijon:

"9. Personeli akademik me kontratë, nga kategoria "Akademik" dhe nga kategoria "Profesor", në cilësinë e personaliteteve vendase ose të huaja, të paguhet me honorarë për ditë/orë pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në institucionet publike të arsimit të lartë. Përcaktimi i masës së honorarëve bëhet me vendim të rektoratit, pasi të jetë miratuar më parë në këshillin e administrimit. Masa e pagesës nuk duhet të jetë më e madhe se 5-fishi i pagesës për orët mbi normë, për kategorinë "Profesor". Mënyra dhe kriteret e këtyre pagesave të specifikohen sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë të Financave. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre pagesave, të përballohen nga të ardhurat e veta të çdo institucioni të arsimit të lartë publik."

4. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, për vitin 2012, të përballohen nga fondet e institucioneve të arsimit të lartë, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK,
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Nr rendor	Pozicioni	Paga
1	Rektor (Titullar institucioni)	129500
2	Zëvendës rektor, nga kategoria "Profesor"	122400
3	Zëvendësrektor, nga kategoria "Docent" / "Doktor"	120400
4	Dekan nga kategoria "Profesor"	122400
	Dekan nga kategoria "Docent" / "Doktor"	120400
5	Zëvendës dekan, nga kategoria "Profesor"	109150
6	Zëvendës dekan, nga kategoria "Docent" / "doktor"	97000
7	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Profesor"	110500
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Docent" / "Doktor"	97000
9	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria "Profesor"	110500
10	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria "Docent" / "Doktor"	97000
11	Profesor	108000
12	Profesor i Asociuar	94000
13	Docent (Doktor)	85500
14	Docent (Master)	82000
15	Lektor i Parë / Kërkues i parë	80600
16	Lektor / Kërkues	65500



VENDIM
Nr. 508, datë 1.8.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 pika 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 640 (gjashtëqind e dyzet) veta. Shtesa prej 1 (një) punonjës është e detajuar sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korente të njëjësive të qeverisjes qendrore, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2012.

3. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr. 4, të përmendur në pikën 1, të depozitojnë në Ministrinë e Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kriterëve të vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008 “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.4

Gr.	Emri i institucionit	Nr.punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
87	Institucione të tjera	1			
	Inspektorati Qendror	1	Punonjës mbështetës	6 orë/ditë	5 muaj
	Total, numri i punonjësve	1			

VENDIM
Nr. 509, datë 1.8.2012

**PËR LIRIMIN, MANDATIMIN DHE RIMANDATIMIN E DISA ANËTARËVE TË
KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Selman Lamaj lirohet nga funksioni i anëtarit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit për shkak të përfundimit të mandatit.
 2. Z. Limos Malaj mandatohet anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, propozuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).
 3. Znj. Flutura Kalemi rimandatohet anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, propozuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.
 4. Z. Jorgji Bollano rimandatohet anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 4.9.2012
Doli nga shtypi më 6.9.2012

Tirazhi 1200	Formati: 61x86/8
--------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 60 lekë